



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. SF ..... Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 25/01/2021

**VENDIM**

Nr.11, date 25 /01/2021

**PËR**

**RREGULLOREN E SHFRYTËZIMIT TË DIGAVE ULËZ, SHKOPET, BISTRICË**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave", VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave" si dhe Udhëzimit Nr.4 të Këshillit të Ministrave, datë 18.07.2003 "Për Kërkesat e dokumentacionit ligjor dhe teknik që duhet të përmbajë dosja e digave dhe dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM),

**VENDOSI:**

- 1- Mos Miratimin e Rregullores së Shfrytëzimit të Digave Ulez, Shkopet dhe Bistrice të paraqitur nga Shfrytëzuesi i diges "KURUM" shpk.
- 2- Ti kërkojë shfrytëzuesit të Digës:
  - Plotësimin e Rregullores me të gjithë elementet e kërkuar në Udhëzimin e Prëgjithshëm të KKDM për Hartimin e Rregullores së shfrytëzimit të digave të mëdha të aprovuar me Vendimin e KKDM Nr. 03, datë 19.10.2020
  - Hartimin e Planeve të Gadishmërisë në rastet e Emergjencave civile në përputhje me Rregulloren e KKDM për Hartimin e Planeve të Emergjencave të aprovuar me Vendimin e KKDM Nr. 05, datë 16.11.2020 si dhe Udhëzimin Nr.248, date 28.01.2000 për Planet e Alarmit;
  - Publikimin e një përmbledhje të planeve të gadishmërisë në rastet e emergjencave civile në faqen e internetit të shfrytëzuesit të digës ku të jepen edhe të dhënat kryesore në lidhje me personat përgjegjës si dhe veprimet që duhet të kryhen për çdo skenar të parashikuar;
  - Përgatitjen dhe dorëzimin pranë KKDM të hartave të matjeve batimetrike për të tre ujëmbledhësit e HEC Ulëz, HEC Shkopet dhe HEC Bistricë në përputhje me Nenin Nr. 30 të VKM Nr.147, datë 18.03.2004 "Rregullore për Sigurinë e Digave dhe të dambave";
  - Përgatitjen e Rregullores së shkarkimit në rastet e plotave për rastet e prurjeve të mëdha me përsëritje një herë në 20 vjet, një herë në 100 vjet dhe një herë në 1000 vjet;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- Përgatitjen e Hartave të Përmbytjeve në zonën poshtë Digës së Shkopetit për rastet e prurjeve të mëdha me përsëritje një herë në 20 vjet, një herë në 100 vjet dhe një herë në 1000 vjet;
- Dërgimin pranë KKDM të Projektit të zbatuar sipas faktit për Rehabilitimin e portave të shkarkuesve katatrofike në Digën e Ulzës dhe aktin e Kolaudimit të këtyre punimeve sipas kërkesave të nenit Nr.24, të VKM Nr.147, datë 18.03.2004

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në përputhje me këtë Vendim dhe legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**

